

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 445 Date 28.07.1993**

**PER KRIJIMIN E AGJENSISE KOMBETARE TE HIDROKARBUREVE**

Me propozim te Ministrise se Industrise Burimeve Minerare dhe Energjitike, ne zbatim te nenit 3 te Ligjit per Hidrokarburet Nr. 7746, date 28.07.1993, Keshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjensise Kombetare te Hidrokarbureve si institucion ne vartesi dhe ne sherbim te drejtperdrejt te Ministrit te Industrise Burimeve Minerare dhe Energjitike e cila ka keto te drejta dhe detyra:
  - Te zbatoje politiken e Qeverise ne fushen e hidrokarbureve dhe te propozoje variante te ndryshme per politikat ne sektorin e hidrokarbureve per kerkimin dhe nxjerrjen.
  - Te negocioje te gjitha marreveshjet hidrokarbure me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.
  - Te ushtroje kontroll per kryerjen e operacioneve hidrokarbure ne perputhje me ligjin, mbi te gjithe kontraktoret ose palet e licensuara.
  - Te pergatise dokumentacionin dhe praktikat e nevojshme per akordimin e lejeve, licencave, autorizimeve ne perputhje me ligjin te cilat mundesojne hyrjen ne marreveshje dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas marreveshjeve te arritura.
  - Te konceptoje dhe te hartoje akte ligjore dhe nenligjore, rregullore dhe kontrata model per gjithe aktivitetet hidrokarbure ne vendin tone.
  - Te ndjeke ne emer te Shtetit Shqiptar te pese kontratat e lidhura me firmat e huaja per operacionet e naftes ne det.
  - Te administroje e perpunoje sipas teknikave a standarteve nderkombetare te dhenat komplekse, gjeologjike, teknike, ekonomike e administrative duke realizuar ekskluzivitetin e pronesis se shtetit mbi te dhenat qe lidhen me veprimtarite e kerkim-shfrytezimit te hidrokarbureve ne Shqiperi dhe per te gjitha problemet e tjera qe shprehin interesat e Shtetit ne sektorin e hidrokarbureve.

- Te marre pjese ne hartimin e planeve te zhvillimit te sektorit te naftes.
  - Te komercializojne ne baze te parimeve te tregut te lire pjesen e hidrokarbureve qe i takojne shtetit ne nje marreveshje hidrokarburesh.
  - Te derdhe ne buxhetin e shtetit fitimet nga shitja pas heqjes se kostove te operimit te Agjensise ne perputhje me buxhetin e miratuar nga Ministri per kete Agjensi.
2. Agjensia Kombetare e Hidrokarbureve organizohet si njesi financiare me vete, e cila me te ardhurat qe do te realizojne te mbulojne shpenzimet.

Duke filluar nga gjashte mujori i dyte i vitit 1993 dhe ne vitet e ardhshme ne dispozicion te kasaj Agjensie do te vihen fondet monetare te percaktuara per administrim dhe kualifikim dhe qe jane parashikuar ne kontratat e lidhura me investitoret e huaj si dhe ato qe do te lidhen ne te ardhmen.

Per gjashte mujorin e dyte te vitit 1993 kesaj Agjensie do t'i vihet ne dispozicion fondi perkates i caktuar per Drejtorine e Negociatave dhe i parashikuar ne programin financiar te ALBPETROL-it, bashke me transferimin e llogarise perkate bankare te Drejtorise se Negociatave.

Te perdore per qellime operimi te Agjensise nje pjese te te ardhurave qe sigurohen nga shitja e pjeses se shtetit ne nje marreveshje hidrokarburesh. Kjo pjese miratohet nga Ministri.

3. Anetaret e Keshillit Drejtues te Agjensise Kombetare te Hidrokarbureve dhe drejtori i saj emerohen nga Ministri. Ata duhet te jene me pervojte dhe me kapacitet ne fushen qe mbulojne. Pagat e punonjesve caktohen mbi bazen e vendimi te Keshillit te Ministrave Nr. 345, date 10.08.1992 "Per shperblimin e punes se punonjesve".
4. Agjensia nuk mundet qe t'i perdore fondet e saj per rinvestime dhe qellime te tjera komerciale. Ajo nuk mund te hyje ne konkurrence me persona fizike e juridike, shqiptare e te huaj per ceshtje komerciale. Fondet dhe te ardhurat e tjera te saj ajo i perdor vetem per qellimet e percaktuara ne piken 1 dhe 2 te ketij vendimi
5. Sistemimi dhe organizimi i Agjensise Kombetare te Hidrokarbureve behet ne ambientet ne dispozicion te Ministrise se Industrise Burimeve Minerare dhe Energjitike. Asaj i transferohet i gjithe inventari fizik i Drejtorise se Negociatave te ALBPETROL-it.
6. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Ministria e Industrise Burimeve Minerare dhe Energjitike.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**Kryetari i Keshillit te Ministrave**

**Aleksander MEKSI**

